



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura IV**

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Legjislacion

Mbledhja nr. 92

Prishtinë, më 21.10.2013, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala S2

**PROCESVERBAL**

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion

**Në mbledhje morën pjesë:** Arben Gashi, Behar Selimi, Mufera Shinik, Arsim Bajrami, Ardian Gjini, Armend Zemaj dhe Sreten Ivanoviq.

**Munguan:** Halit Krasniqi, Haki Demolli, Albulena Haxhiu dhe Gëzim Kelmendi

**Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë:** Lumnije Murati – ZPRK, Donjetë Hoxha – BIRN, Baki Gimolli-MD, Syle Ahmeti – Kosova Sot, Avni Tusha, Gurjeta Zeka dhe Astrit Gjocaj – Praktikant.

**Nga stafi i Komisionit për Legjislacion:** Idriz Tahiri, Fehmi Hyseni dhe Visar Krasniqi.

**Mbledhjen e kryesoi,** Arben Gashi, kryetar i Komisionit.

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i Procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më 22 dhe 26.7. 2013,
3. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-222 për administratën tatimore dhe procedurat, te ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-102,
4. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin për 04/L-196 për Fshatin Zymi i Hasit,
5. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për nr. 04/L-050 për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë,
6. Të ndryshme

**1. Miratimi i rendit të ditës**

**Behar Selimi** – propozoj që në rend të ditës të futet edhe Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me mandatin e EULEX-it.

*Kryetari e hodhi në votim propozimin dhe konstatoi se me 3 vota “për” dhe 3 “kundër”, Komisioni nuk e miratoi propozimin.*

## **2. Miratimi i Procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më 22 dhe 26.7. 2013**

*Kryetari konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalet nga mbledhjet e mbajtura më 22 dhe 26.7. 2013, pa vërejtje.*

## **3. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-222 për administratën tatimore dhe procedurat, te ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-102**

**Kryetari** – Tha se ky Projektligj ka një problem jashtëzakonisht të madh dhe ka përmbajtje të theksuar antikushtetuese. Kjo formë e shkruar kështu ndërton praktikën e fuqisë prapavepruse të ligjit ose siç njihet ndryshe retroaktive dhe besoj që është praktikë e rrezikshme. Ligji nuk mund të rregulloj diçka të shkuar por diçka në të ardhmen. Neni 25 i Projektligjit dhe amendamentit 4 nuk është në mospajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm. Me dispozitën e nenit 4 të Ligjit nr. 04/L-102 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për administratën tatimore dhe procedurat nr. 03/L-222 është hequr baza ligjore që përcakton subjektin që i propozon, që i emëron dhe për mandatin e anëtarëve të bordit.

Me këtë dispozitë është përcaktuar kompetenca e bordit për rishqyrtime për të shqyrtuar me të gjitha ankesat të cilat duhet të dorëzohen deri me 30 nëntor 2012. Po ashtu edhe me dispozitën e nenit 6 të këtij ligji është përcaktuar afati 31 dhjetor 2013 për përfundimin e të gjitha rasteve të pazgjidhura nga bordi. Andaj vlerësoi se mandati i disa anëtarëve të bordit ka përfunduar kurse për disa të tjerë është duke vazhduar mbi bazën e vendimit për emërimin e tyre dhe duhet të përfundoj në pajtim mandatin e përcaktuar me atë vendim. Pasi që baza juridike për propozimin, emërimin dhe mandatin e anëtarëve të bordit është hequr është e nevojshme që me këtë ligj të përcaktohet autoriteti që propozon, emëron dhe mandati i anëtarëve të bordit. Ndërtimi i praktikës duke futur dispozita me fuqi retroaktive dhe për zgjatjen dhe ndërprerjen e mandatit, me ligj, pa ju nënshtruar procedurave formale paraqet bazë për diskriminim dhe krijon precedent të pa nevojshëm në praktiken e hartimit të legjislacionit.

**Armend Zemaj** – Tha se kjo çështje është e njohur për neve sepse është plotësuar e ndryshuar që 2 apo 3 herë sa jam unë këtu gjatë mandatit të parë. Ai është bord i pavarur që bënë shqyrtimin e ankesave, është një lloj mini-gjykate mbi administratën tatimore dhe procedurat. Ndërhyrjet e tilla politike që mundë të jenë, si bord i pavarur, është shkelje edhe e të drejtave të bizneseve edhe është ndërhyrje direkte në kacen buxhetore, andaj mendoj se nuk duhet të lejohet.

*Kryetari konstatoi se Komisioni, në mënyrë unanime vendosi që Komisionit FunkSIONAL t’ia paraqesë këtë*

### **Rekomandim**

1. Projektligji nr. 03/L-222 për administratën tatimore dhe procedurat, te ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-102 dhe amendamentet e propozuara, nuk janë në mospajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm, përveç nenit 25 të Projektligjit dhe amendamentit 4.

2. I rekomandohet Komisionit funksional që neni 25 i projektligjit dhe amendamenti 4 të riformulohet duke definuar procedurat për propozimin, emërimin dhe mandatin e anëtarëve të bordit.

**4. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funksional në Projektligjin për 04/L-196 për Fshatin Zymi i Hasit.**

**Kryetari** - edhe ky Projektligj , ka mangësitë e veta dhe mendoj se po krijohet një traditë e ndërtimit asimetrik të kapaciteteve të qeverisjes lokale, dhe ne e dimë që në Kushtetutën e Republikës së Kosovës thuhet se *njësi themelore e qeverisjes lokale është komuna* . Dhe ky Projektligj përbën një tejkalim, ne veç e kemi një praktikë të tillë për fshatin Hoqë e Madhe. Mirëpo krijimi i këshillave dhe mandati i tyre thotë te neni 3 pika 4, dhe pika 5, se këshilli është një trup i vetëqeverisjes lokale e ndryshme prej komunës, dhe duke përfshirë edhe dispozitat kalimtare mendoj se po krijohet një precedent i rëndë, dhe për mendimin time mendoj se është me përmbajtje të dyshuar kushtetuese.

**Ardian Gjini** - mendoj se arsyeshmëria e këtij ligji është dhënë në seancë kur është votuar në lexim të parë dhe ka kaluar në lexim të parë. Në lexim të dytë unë e kam shikuar me kujdes dhe prapë se prapë komuna është autoriteti kryesorë dhe vendos për këshillat dhe gjërat tjera, mirëpo është provuar të ruhet një karakter i veçantë i fshatit Zymi i Hasit. Andaj vlerësoi se nuk del jashtë ombrellës së komunës dhe mendoj se është shumë me e theksuar kjo se sa te fshati Hoqë e Madhe.

**Arsim Bajrami** – Tha se arsyeshmëria e këtij projektligji është diskutuar dhe mendoj se në aspektin e lëshimeve kushtetuese, unë këtë nuk po e shoh si celulë pushteti, por si një organ për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe historike. Mendoj se ne duhet ta votojmë në leximin e dytë pa frikë se po krijohet një strukturë e tretë e pushtetit.

*Meqë nuk kishte vërejtje tjera, kryetari konstatoi se Komisioni, me 2 vota kundër, nxori këtë*

***R e k o m a n d i m***

1. Projektligji nr. nr. 04/L-196 për Fshatin Zymi Hasit dhe amendamentet e propozuara, nuk janë në mospajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.
2. Projektligji me amendamentet e propozuara, mund ti procedohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.
5. **Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 04/L-050 për deklarin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe deklarin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë.**

Komisioni e shqyrtoi në parim Projektligjin nr. 04/L-050 për deklarin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe deklarin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë dhe vlerësoi se projektligji ka bazë kushtetuese. Në aspektin përmbajtësor, i plotëson kushtet e përcaktuara me rregullat e hartimit të legjislacionit, si dhe kushtet e caktuara me Rregulloren e Kuvendit, për t'u proceduar për shqyrtim dhe për miratim në parim, prandaj vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë

## **R e k o m a n d i m**

*Të shqyrtohet dhe të miratohet, në parim, Projektligji nr. 04/L-050 për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë*

### **6. Të ndryshme**

- a. Formimi i Grupit punues në Projektligjin për mbikëqyrjen elektronike të personave të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim të gjykatës ose të panelit për lirim me kusht.**

Formohet Grupi i punës për shqyrtimin e Projektligjit për mbikëqyrjen elektronike të personave të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim të gjykatës ose të panelit për lirim me kusht në përbërje:

- Armend Zemaj - kryesues
- Behar Selimi - anëtar
- Albulena Haxhiu – anëtar
- Sreten Ivanoviq- anëtar

Mbledhja përfundoi në orën 11:15

E përgatiti:  
Stafi Mbështetës i Komisionit

Kryetari i Komisionit

---

**Arben Gashi**